

## Interreg MED: Projekti EnerNETMob synon të përmirësojë SEMPs (Planet e Elektro-Mobilitetit të Qëndrueshëm)

Partnerët e projektit nga 12 shtete po punojnë së bashku me objektiv përmirësimin e SEMPs dhe ngritjen e një Rrjeti Elektromobiliteti Ndër-rajonale në zonën MED, me një financim prej 5,74 mil € nga programi Interreg-MED.

**Projekti harton, teston dhe përmirëson paralelisht “Planet për Elektromobilitetin e Qëndrueshëm”** sipas standarteve dhe politikave të përbashkëta për karbon të ulët, në mënyrë që të ngrihet një **“Rrjet Elektromobiliteti Ndër-rajonale”** që kalon nëpër qytetet e gjithë zonës Interreg MED. Partneriteti i projektit koordinohet nga Rajoni i Peleponezit – Departamenti i Menaxhimit për Planifikimin e Zhvillimit, dhe përbëhet nga 16 partnerë nga 12 shtete të ndryshme MED, përfshirë autoritete vendore, agjensi sektoriale dhe autoritete të infrastrukturave apo shërbimeve të transportit EnerNETMob do të mundësojë një bazë për zhvillimin e Planeve të Elektromobilitetit të Qëndrueshëm.

### ✓ *Partneritet gjithëpërfshirës*

Projekti EnerNETMob (Rrjetet e Elektromobilitetit Ndër-rajonale Mesdhetar për sisteme transporti intermodal dhe interurban me karbon të ulët) shqyrton dhe integron politika transporti kombëtare dhe rajonale me karbon të ulët duke ndërlidhur sistemet e elektromobilitetit në nivel ndër-rajonale dhe ndërrurban.

### ✓ *Bashkëpunim ndërkombëtar*

Nevojitet një qasje me bashkëpunim ndërkombëtar për të integruar politika

Kombëtare/Rajonale/Vendore dhe për të bashkuar strategjitë për transport me karbon të ulët, me qëllim përhapjen dhe transferimin e rezultateve të projektit. Projekti mbulon 12 shtete dhe partnerë të ndryshëm kontribuojnë dhe bashkëpunojnë për të transferuar dhe kapitalizuar rezultatet e politikave dhe planeve. Partnerët gjithashtu do të zbatojnë aksione pilote për të testuar dhe ndarë një grup të parë rrjetesh të integruara të infrastrukturës lokale që lidhin rajonet ndërkombëtare dhe zonat urbane.

### Aspekte kritike

Projekti do të trajtojë dy sfida kryesore që ekzistojnë aktualisht:

- Territori i BE, deri më sot, nuk ka integruar akoma “Rrjete Infrastruktura të vogla” që lejojnë zhvendosje në distanca të gjata me Automjete me Bateri Elektrike (BEV) për shkak të mungesës së infrastrukturës së karikimit dhe standarteve të përbashkëta.
- Në rajonet MED, shumë qytete të vogla kanë nevojë të zhvillojnë politika të ndryshme të lëvizshmërisë së qëndrueshme, për shkak të zhvendosjeve ndërrurbane më të shpeshta në distanca më të gjata.

Brenda këtij projekti, SEMPs dhe zgjidhjet për transportin elektrik do të pranohen dhe miratohen nga politika mobiliteti kombëtare dhe rajonale për transport interurban me karbon të ulët.

## EnerNETMob Video dhe Mediat Sociale

### Zbulo më shumë për ne!

Shiko [videon](#) tonë në kanal tonë në YouTube:



Lidhuni me ne!

[@EnerNETMob](#)



[@Enernetmob](#)



## EnerNETMob në veprim!

Në bazë të teknologjive më të mira të mundshme ekzistuese, projekti **është gati të fillojë aksionet pilote** me qëllim testimin e funksionalitetit, përfitimeve dhe riprodhimit paralelisht të “Rrjeteve Infrastrukturore në Shkallë-të-Vogël” dhe lidhjet e tyre me protokollet ICT dhe standartet e përbashkëta. Partnerët zbatues të projektit (PP) do të testojnë “Rrjetet e tyre vendore Infrastrukturore në Shkallë-të-Vogël” të planifikuar në fazën e studimit. Faktikisht, të gjithë partnerët së bashku do të ndërmarrin zbatimin e aksioneve pilote me investime në shkallë të vogël për të testuar dhe ndarë një grup të parë të rrjeteve të integruara të infrastrukturës lokale për të lidhur rajonet ndërkombëtare dhe zonat urbane.

Aktiviteti do të ketë **tri sfida kryesore me temë** elektromobilitetin: **transporti intermodal det-rrugë, shkëmbimi i mobilitetit dhe logjistika e qytetit.**

### AKSIONI PILOT 1: Të lidhësh ishuj dhe zona urbane: ja se si

Ishujt dhe zonat urbane nuk kanë qenë kurrë kaq afër!

Partnerët që drejtojnë këtë aksion pilot po punojnë drejt implementimit të rrjeteve të

elektromobilitetit intermodal det-rrugë. Në thelb të këtij projekti është kombinimi i mënyrave të ndryshme të transportit, me një fokus të veçantë në linjat e kombinuara të transportit. Qëllimi kryesor është rritja e kilometrazhit të përshkruar të automjeteve me bateri elektrike. Për këtë qëllim, **do instalohen disa pika karikimi publike dhe blihen disa automjete elektrike** në zona të caktuara në Shqipëri, Greqi, Mali i Zi dhe Maltë për të implementuar ndërlidhjen trans-kufitare ndërmjet rrjeteve të infrastrukturës në shkallë- të-vogël.

### AKSIONI PILOT 2: Shkëmbimi i elektromobilitetit: le të bëhemi të qëndrueshëm

Sistemet e ndarjes (shkëmbimit) të makinave (car-sharing dhe bike-sharing) në zonat më të mëdha urbane të BE-së, janë marrë si model për të kombinuar RES (Burimet e Rinovueshme të Energjisë) dhe sistemet e shkëmbimit të elektromobilitetit. Aksioni pilot do të zbatohet në disa zona MED si Qipro, Greqi (Korinth dhe Argolis), Itali (Raguza), Kroaci (Goriška) dhe Spanjë (Barcelona). Partnerët përgjegjës, kanë nisur të zhvillojnë rrjetet lokale të infrastrukturës në shkallë-të-vogël, me qëllim që të vlerësojnë sistemet e shkëmbimit të elektromobilitetit, me vëmendje të veçantë në e-car pooling, e-car sharing dhe e-bike sharing. Përveç kësaj, partnerët do të testojnë sistemet e-bike sharing të projektuara posaçërisht për njerëzit me aftësi të kufizuara.

**Qëllimi përfundimtar është menaxhimi i kërkesës më të lartë të elektricitetit për elektromobilitetin dhe realizimi i ndërlidhjes ndërkufitare ndërmjet rrjeteve të mundshme të infrastrukturës me shkallë-të-vogël.**

### AKSIONI PILOT 3: Logjistika e qytetit: zvogëlimi i impaktit mjedisor dhe ekonomik

Partnerët në drejtimin e këtij aksioni pilot po punojnë për zhvillimin e rrjeteve të infrastrukturës me shkallë-të-vogël në nivel

lokal. Objektivi i tyre është zbatimi në zonat urbane i zgjidhjeve të transportit elektrik të mallrave për sistemet logjistike të qytetit. Automjetet me Bateri Elektrike (BEV) po përdoren si mjeti kryesor për arritjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe më pak të kushtueshme me qëllim zvogëlimin e impaktit mjedisor dhe ekonomik. Qëllimi i këtij aksioni pilot është **testimi i logjistikës së qytetit për lidhjet fundore të transportit të mallrave** në zona urbane si Bouches-du-Rhône (Francë), Lisbonë (Tripoli) dhe Trapani (Itali), duke zbatuar një model shpërndarjeje si në zona metropolitane ashtu edhe lokale.

Së bashku me shoqatat e fermerëve dhe SME-të, partnerët e projektit po testojnë një model biznesi për zinxhirët agro-ushqimorë të pajisur me automjete elektrike dhe të karikuar edhe nga RES. Ndërkohë, po studiohen lidhjet ndër-kufitare mes rrjeteve infrastrukturore me shkallë-të-vogël, si pjesë e një rrjeti më të gjerë elektromobiliteti ndër-rajonat.

## EnerNETMob i publikon rezultatet e veta sipas Direktivave Kombëtare për Elektromobilitetin

Politika e BE-së dhe Kuadri Rregullator për Elektromobiliteti

Partneriteti i EnerNETMob publikon në [website-in e projektit](#) raportin e integruar të analizave paraprake për përcaktimin e standarteve të politikave të BE-së dhe Rregulloreve/Direktivave të miratuara nga Komisioni i BE-së dhe Parlamenti Europian dhe që duhen zbatuar në nivel kombëtar.

Objektivi i raportit është përcaktimi i kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe politikave në nivel europian dhe të analizojë dhe krahasojë gjendjen aktuale për çdo shtet anëtar

dhe/ose rajone të përfshira në projektin EnerNETMob.

### Kuadri ligjor i BE-së

Pjesa e parë e raportit jep zhvillimin aktual të elektromobilitetit në BE duke kryer një analizë të hollësishme të politikave dhe rregulloreve në nivel Europian. Analiza fokusohet në:

- Politikat dhe rregulloret mbi transportin elektrik
- Politikat dhe rregulloret mbi energjinë e qëndrueshme
- Politikat dhe rregulloret mbi mobilitetin e qëndrueshëm
- Politikat dhe rregulloret mbi cilësinë e ajrit

### Kuadri ligjor kombëtar

Pjesa e dytë e raportit fokusohet në kuadrin ligjor kombëtar të shteteve anëtare të përfshira dhe përmban një përmbledhje të analizës së Kuadrit të Politikave Kombëtare të kryera nga përfaqësuesit e 12 partnerëve të projektit që përfshijnë:

- Direktiva e BE-së mbi transportin elektrik
- Marrëveshja e Kryetarëve të Bashkive dhe SEAPs (Plani i Veprimtimit për Energjinë e Qëndrueshme)
- Mobiliteti i Qëndrueshëm dhe SUMP (Plani për Mobilitetin e Qëndrueshëm Urban)
- Standartet lokale në secilin shtet duke theksuar praktikatat më të përshtatshme.

## Aktivitetet e rëndësishme të EnerNETMob!

Circle2019 “Sfidat për ishujt në epokën e Ekonomisë Qarkulluese” & Smile2019 “Konferenca e 6-të e Mobilitetit të Qëndrueshëm dhe Transportit Inteligent”, 28-29 Mars 2019, Nikosia, Qipro



Në kuadër të projektit, në eventin “Ditët e Hapura Rajonale” në Qipro, EnerNETMob ishte bashkë-organizues i Konferencës Ndërkombëtare Circle&Smile2019. I gjithë partneriteti u përfshi shumë me prezantime, duke shijuar interesin për eventin të 350 pjesëmarrësve nga 20 shtete. Zbuloni më shumë [këtu!](#)

"Prezantimi i projekteve të bashkëpunimit territorial europian mbi efikasitetin e energjisë dhe energjinë e rinovueshme", 4 Prill 2019, Romë, Itali



Ram Logistica Infrastrutture e Trasporti S.p.a, partner i projektit EnerNetMob, mori pjesë në konferencën **“Prezantim i projekteve të bashkëpunimit territorial europian mbi efikasitetin e energjisë dhe energjinë e rinovueshme”**, që u zhvillua në Romë më 4 Prill 2019 në godinat e Rajonit të Lacios, për të nxitur ndërgjegjësimin publik për aktivitetet e EnerNETMob dhe vlerës së tyre të shtuar.

Eventi kishte si qëllim t'i prezantonte audiencës një listë gjithëpërfshirëse të projekteve dhe iniciativave mbi efikasitetin e

energjisë dhe energjinë e rinovueshme që momentalisht prekin Rajonin e Lacios.

Gjatë takimit Ram prezantoi aktivitetet kryesore, sfidat dhe rezultatet e pritshme të projektit EnerNETMob, duke theksuar impaktin pozitiv të politikave lokale dhe europiane në promovimin e automjeteve elektrike për zvogëlimin e emetimeve të gazeve serrë dhe impaktin mjedisor të sektorit të transportit. Zbuloni më shumë [këtu!](#)

“Kurse trajnimi të nivelit të lartë mbi mobilitetin e qëndrueshëm”, 11-13 Qershor 2019, Barcelona, Spanjë.



CIMNE, Dynamic Vision dhe Ministria e Transportit, Komunikimeve dhe Punëve publike të Qipros, përfaqësuan EnerNETMob në eventin “Komuniteti i Transportit Urban MED” duke u fokusuar në përfshirjen e qyteteve të Mesdheut jugor në lidhje me Mobilitetin e Qëndrueshëm. Partnerët e projektit patën mundësinë të prezantonin vlerësimet e projektit në tema që lidheshin me mundësitë financiare dhe lidhjet midis Mobilitetit dhe Turizmit të Qëndrueshëm. Zbuloni më shumë [këtu!](#)

EBN TechCamp, 27-29 Qershor 2019, Toulon France.



EnerNETMob u përfaqësua nga Capenergies në TechCamp organizuar në kuadër të seminarit “Qytetet Inteligjente që promovojnë Mobilitetin e Qëndrueshëm” organizuar nga Komuniteti i Transportit Urban MED. Zbuloni më shumë [këtu!](#)

Konferenca vjetore e 12-të e Akademisë së Biznesit (EMAB), 18-20 Shtator 2019, Selanik, Greqi.



UNIPA përfaqësoi EnerNETMob në këtë konferencë madhore të Menaxhimit të Biznesit, duke prezantuar rezultatet e para të projektit në një studim me titull “Prirja e sipërmarrësve për të pranuar mobilitetin elektrik në zinxhirin e shkurtër të furnizimit ushqimor”. Zbuloni më shumë [këtu!](#)

Eveti final Remedio, 1-2 Tetor 2019, Treviso, Itali.



EnerNETMob mori pjesë në eventin final të projektit Interreg MED “REMEDIO”. Projekti u prezantua nga Dynamic Vision. Zbuloni më shumë [këtu!](#)

Mbledhja e 4-rt e Komitetit Drejtues të projektit, 30-31 Tetor 2019, Maltë.



Mbledhja e 4-rt e Komitetit Drejtues të projektit EnerNETMob u zhvillua në Maltë, drejtuar nga partneri i projektit Transport Malta. Partnerët diskutuan mbi progresin e projektit dhe përcaktuan ecurinë e rradhës drejt një të ardhmje më “elektrike”! Zbuloni më shumë [këtu!](#)

Projekti GreenBuildingENI CBC, 20 Nëntor 2019, Tripoli, Greqi.



Dynamic Vision prezantoi projektin EnerNETMob në Takimin Startues të projektit GreenBuilding duke shfrytëzuar mundësinë për të promovuar progresin e projektit dhe zgjeruar rrjetin e tij me shtete në bregun jugor të Mesdheut. Zbuloni më shumë [këtu!](#)

## Kalendari për Ditët e Hapura Rajonale

Mos i humbisni eventet tona të ardhshme!  
Ndiqni kalendarin e Komunitetit [këtu](#) dhe  
qëndroni të lidhur!



Project co-financed by the European  
Regional Development Fund

